

Sh.T. Z. Avni Spahiu

Ambasador i Jashtëzakonshëm dhe Fuqiplotë

Ditëlindja: 12 mars 1956

Vendlindja: Mitrovicë

Arsimimi

Universiteti i Prishtinës, Master në Letërsi (2004)

Studime postdiplomike në Letërsi në Fakultetin e Filologjisë të Universitetit të Prishtinës (1988)

Fakulteti i Filologjisë, Departamenti i Gjuhës Angleze, Prishtinë (1978)

Shkolla e mesme në Elk Rapids, Michigan, SHBA (1974)

Gjimnazi në Mitrovicë, (1972)

Të arriturat

2012-2019: Ambasador i Republikës së Kosovës në Turqi - Ankara – ambasador jorezident edhe për Republikën Islamike të Pakistanit dhe Mbretërinë Hashemite të Jordanisë.

2008-12: Ambasador i parë i Jashtëzakonshëm dhe Fuqiplotë i Kosovës në Uashington, DC.

2008: I emëruar si Shef i parë i Misionit Diplomatik të Kosovës në Uashington, DC.

2003: Drejtor i Departamentit të Radios i Radio Televizionit të Kosovës, për dy radiot nacionale (Radio Kosova dhe Radio Blue Sky)

2002-2003: Drejtor i Televizionit të Kosovës (Transmetuesit Publik të Kosovës)

1999-2000: Kryeredaktor i Radio Televizionit të Kosovës (RTK)

1994-1998: Kryeredaktor i së përditshmës Rilindja

1990-1995: Këshilltar politik i Presidentit Ibrahim Rugova

1990: Bashkëthemelues i agjencisë së parë të lirë të lajmeve, Qendrës për Informim të Kosovës.

1982-1986: Korrespondent i përhershëm në OKB/SHBA në Nju-Jork i gazetës Rilindja.

1978: Gazetar dhe raportues për lajmet ndërkombëtare në gazetën Rilindja.

Fushat e interesit

Të drejtat e njeriut: Gjatë viteve 90, së bashku me intelektualët kryesorë të Kosovës, në suazat e levizjeve demokratike, ai ka qenë themelues i Këshillit të parë të të Drejtave të Njeriut. Në këtë kapacitet, ai ka marrë pjesë në sesionet e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut në Gjenevë, dhe ka folur para Komitetit për të Drejtat e Njeriut të Kombeve të Bashkuara, diskutimet e tryezave të rumbullakta në shumë kryeqytete për çështje politike dhe të drejtat e njeriut, si p.sh. në OSBE, Konferencën e Dimensionit Human në Kopenhagë, në Norvegji, Suedi, Gjermani, Austri, etj.

Përkthimet: Në ndërkohë, ai ka qenë i dedikuar përkthimeve prej shqipes në anglisht dhe anasjelltas. Deri më tani, ka përkthyer mbi 20 botime të literaturës dhe mendimit Perëndimor. Ai gjithashtu ka përkthyer poezi të shkruara nga poetë të famshëm britanezë dhe amerikanë. Ai ka qenë themelues dhe nënkryetar i PEN Qendrës të Kosovës.

Publikimet

“Faqe të miqësisë” – anglo-amerikanë për Shqipërinë dhe shqiptarët.

“Skica amerikane” – eseistike nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

"Fan Noli – jeta në Amerikë," (gjithashtu në gjuhën angleze 'Noli's American Years – Notes on a Great Albanian-American');

"Nobelistët e letërsisë;"

"Teach me to love" (Poezia e Nënës Tereze – përkthim);

"Do you come from Chameria"

"A Split Stone," etj.